



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.365/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjykatëcivile e shkallës së parë, me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (në vijim KEDS) Dega në Gjilan, të cilën e përfaqëson Driton Rexhepi jurist në Kompani, e paraqitur kundër të paditurit S. R. R. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti, kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 162,93€ , pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datën 20 tetor 2020, jashtë seancës gjyqësore më datën 5 Nëntor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

LMIRATOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses KEDS Sh.A Dega në Gjilan, e paraqitur ndaj të paditurit S. R. R. nga fshati ... dhe DETYROHET i padituri, që paditëses të i'apaguaj shumën prej 162,93€, në emër kompensimit material për shpenzimet e energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar , me kamatë ligjore në lartësi prej 8 %, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri ne pagesën definitive, si dhe shumën prej 20 euro për taksën gjyqësore , të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, KEDS sh.a Dega në Gjilan, në këtë gjykatë më datën 25.04.2019, ka paraqitur padi ndaj të paditurit S.R., për kompensimin e dëmit material në shumë prej 162.93 euro, të shkaktuar me rastin e shpenzimit të energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri, në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim që për shkak të gjendjes së dobët ekonomike që ka dhe në pamundësi që të blejë njuhësorin elektrike në shitoren përkatëse , e ka blerë atë në treg në shumë prej 20 euro dhe në atë gjendje si ka qenë e ka vendosur (nuk e ka ditur që njuhësor elektrik nuk e regjistron rrymën). Më tutje ka theksuar që jeton me ndihma sociale që merr nga 100 euro në muaj

Ndërkaq shqyrtimi gjyqësor i datës 20.10.2020, me propozimin e të autorizuarit të paditëses është mbajtur në mungesë të të paditurit pasi që nga fletëdërgesat e gjykatës e dorëzuar përme shërbimit postar, konstatohet që ftesën e ka pranuar bashkëshortje e tijë e cila ka deklaruar që bashëshorti i saj gjindet në Francë, dhe në kuptim të nenit 116 të Lpk konsiderohet që thirrja i është bërë në mënyrë të rregullt , nuk ka qenë i pranishëm në gjykatë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i paditëses në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar që mbetet në tërësi si në padiës dhe këkresëapdisë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin për kompensimin e dëmit material në shumë prej 162,93€, meqë paditësi nga data e pa vërtetuar e deri më datën 14.04.2013 në shtëpinë e tij e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar me çka është konstatuar se ka keqpërdorur njehsorin elektrik dhe i ka shkaktuar dëm materila paditëses në shumën e lartëceku, e cila është vërtetuar edhe në bazë të Aktgjykimit penale të kësaj gjykate P.nr.635/14 i datës 18.11.2015 dhe nga transakcionit të konsumatorit me shifër DGL-9032119. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të paguaj edhe taksën gjyqësore në shumë prej 20 €.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje civilo juridike, në shqyrtimin kryesorë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Aktgjykimi penal P.nr.635/14 i datës 18.11.2015 i plotëfuqishëm më datë 24.11.2015, transakcionet e konsumatorit me nr.DGL-9032119 të datës 13.04.2019 dhe 20.10.2020, në emër të të paditurit .

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe deklaratave të palëve ndërgjyqësve dhe fakteve jo kontestuese në mes tyre, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: që i padituri prej datës së pavërtetuar e deri më datën 14.03.2019 në shtëpinë e tij me qëllim që të i sjell vetit përfitim të kundërligjshëm ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar ashtu që nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS Dega në Gjilan, kanë konstatuar se njehsori i një bllobme është këputur dhenë këtë mënyrë i është pamundësuar regjistrimi i energjisë elektrike, fakt ky i vërtetuar nga Aktgjykimi penal P.nr.635/14 i datë 11.11.2015 e i formës së prerë me datën 05.01.2016 ku i padituri është shpallur fajtor dhe është denuar me dënim me kusht.

Nga transakcionet e konsumatorit me nr.DGL-9029033 e datës 13.04.2019 dhe 20.10.2020, gjykata vërtetoi faktin që të njëjtat evidentuar në emër të të paditurit S. R. R. nga Gjilani.

Duke u bazuar në faktin se kontrata për shërbimet është kontratë e dyanshme ngarkuese, respektivisht krijon të drejta dhe detyrime për dy palët, e që paditësja në tërësi e ka përmbushur detyrimin e saj duke i ofruar shërbime për shfrytëzimin e energjisë elektrike të paditurit, atëherë rrjedh edhe detyrimi i të paditurit që ta shpërblejë paditësen me pagesën e këtyre shërbimeve si kundër shpërblim.

Këtë detyrim e ka përcaktuar shprehimisht neni 136 i LMD/Ligji nr.04/L-077 i vitit 2012 që është në fuqi në kohën e themelimit të raportit juridiko- civil në të cilën nënë parashihet që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveqë nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin etij”*.

Prandaj duke u bazuar në faktin se paditësja në tërësi i ka përmbushur detyrimet ndaj të paditurit atëherë gjykata të njëjtin e ka obliguar që paditëses t'ia paguaj dëmin e shkaktuar për shpenzimet e energjisë elektrike në shumë prej 1621,93€, me kamatë ligjore

në lartësi prej 8 %, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri ne pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që ta detyroj të paditurin që ta paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 20€ duke u bazuar në nenin 463.1 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar në nenin, si dhe nenit 143 të LPK-se, dhe nenit 345 të LMD-ës së re, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshë, Divizioni Civil
C.nr.365/2019, më datën 5 Nëntor 2020**

**Gjyqtarja,
Mirvete Alidemi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.